

Nr.Prot. 554 / 2025Tiranë 12/09 / 2025

Lënda: Njoftim mbi Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Drejtuar: Anëtarëve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Të nderuar Anëtarë,

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr.10091, date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit dhe kontabilistit të miratuar”, **nenit 9 dhe 13 të Statutit** të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), ju informojmë se thirret Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të IEKA-s, e cila do të zhvillohet më datë **17 Tetor 2025**, ora **10.00**, në ambientet e Hotel Tirana International, Tiranë me rend dite si më poshtë:

1. Diskutimi dhe Miratimi i Pasqyrave Financiare 2024;
2. Prezantim nga audituesi i jashtëm dhe diskutim mbi Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare 2024;
3. Prezantimi i Raportit Vjetor të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm;
4. Prezantimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të aktivitetit dhe veprimtarisë financiare për vitin 2024.
5. Propozim për rishikimin e Projekt-Buxhetit për vitin 2025;
6. Paraqitja e Kandidaturave dhe zgjedhja e Këshillit Drejtues dhe organeve të tjera drejtuese, sipas Statutit.
7. Diskutime të hapura
8. Procesi i Votimit për pikat e rendit të ditës.

Paraqitja e Kandidaturave

- Kandidaturat duhet t’i paraqiten Kryetarit të Këshillit Drejtues të paktën **20 ditë përpara datës së mbledhjes** dhe duhet të kenë miratimin me shkrim e të paktën pesë anëtarëve të Asamblesë.

Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi

- Votimi është individual dhe anëtarët nuk mund të përfaqësohen në mbledhjen e Asamblesë nga një anëtar tjetër i pajisur me prokurë apo autorizim.

Jeni të lutur të respektoni ndalimin e çdo forme fushate apo publiciteti personal, në përputhje me **nenin 13.4 të Statutit**.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe ju ftojmë të merrni pjesë aktivisht në vendimmarrjen për të ardhmen e profesionit tonë,

Berti Pashko

Kryetar i Këshillit Drejtues

